



Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Prishtinë, Datë: 22.11.2018

Nr.020-1282/12

Për: **Agim Aliu**, Kryetar i Komunës së Ferizajt

Kristina Gashi Byryqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Ferizajt

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Vendimin 01Nr.155 të datës 31.10.2018, për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit dy palësh**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt dhe nënshkruar nga Kryesuesja e KK të Ferizajt, më qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 14.11.2018, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Financave.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MF lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

MAPL, kërkon nga Komuna që zyrtarisht të njoftohet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve konkrete për rishqyrtimin e këtij akti.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministrarsvo za Finansije / Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësiti i punës Unit 02/ky	Nr. i protokollit Prot. No. 2229-1
Nr. i llogaritjes Prot. shifra 7	Data e miratimit Date 21.11.2018
Prishtinë / Pristina	



QEVERIA E KOSOVËS / QEVERIA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO	
Ministri i Punëve të Përgjithshme / Ministarstvo Opšte uprave / Administration 21.11.2018	
-01-	020-12 p2 / 12

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Financave - Ministrarsvo za Finansije - Ministry of Finance

DATË/A:	19.10.2018
REFERENC-Ë:	275 / 2018
PËR/ZA/TO:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Naim Baftiu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
NGA/OD/FROM:	Komisioni për mbikëqyrjen e përshtatshmërisë së akteve të Komunave: 1. Bahrije Berisha - Kryesuese: <i>BB</i> 2. Lumije Hetemi - Anëtare: <i>Lumije</i> 3. Jak Ndrecaj - Anëtar: <i>Jak</i> 4. Imer Rudari - Anëtar: <i>Imer</i> 5. Artë Vehapi - Anëtare: <i>Artë</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shqyrtimi i Vendimit 01 Nr.155 për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit dy palësh



E nderuara znj. Ukimeraj,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave dhe Vendimit Nr. 88/2016 të dt. 15.06.2016 Komisioni për Vlerësimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunave, në shkresën e pranuar, me datë 14.11.2018 me Nr. Protokollit 2229, të Vendimit 01 Nr.155 për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit dy palësh, në mes të Komune së Ferizajt-Agim Aliu dhe Caritas Kosova-Viktor Sopi, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt dhe nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, për vlerësim të ligjshmërisë.

Komisioni pas vlerësimit të përshtatshmërisë në bazë të nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka shqyrtuar vendimin e lartcekur dhe vlerëson se me këtë marrëveshje të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit **nuk është zbatuar** Rregullorja MF-Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve¹.

Zbatimi i akteve ligjore dhe nën ligjore është obligim i të gjitha Organizatave Buxhetore për zbatimin e drejt efikas dhe efektiv të parasë publike. Ky vendim duhet të shfuqizohet sepse është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14831>